



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Komunitete**  
Nr.01-06/01-21921/21 datë: 24.08.2021



Npi – 01/232 datë: 30.08.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.08.2021, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**  
E mbajtur më: 30.08.2021 (e hënë) në ora 14.00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, znj.Xhevahire Ramadani dhe z.Arton Demiri, në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga zyra për Informim z.Lulzim Sahiti. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Rahman Kadrija i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 13.07.2021,
2. Mundësitë e bashkëpunimit me KFOR, UNHCR, Terres des Homes, dhe OJQ, tjera për qështje të komuniteteve Ashkali dhe Rom,
3. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.**

**\* Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika I

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 13.07.2021

**Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.**

**\* Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 13.07.2021.**

## Pika 2

### Mundësitë e bashkëpunimit me KFOR, UNHCR, Terres des Homes, dhe OJQ, tjera për qështje të komuniteteve Ashkali dhe Rom

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Sa i përket OJQ-ve si dhe organizatave tjera ne kemi pas bashkëpunim të mirë me KFOR-in Turk, të cilin e falënderojmë, që na ka ndihmuar me pako ushqimore disa herë. Po ashtu e falënderojmë edhe organizatën IOM-i e cila po ashtu na ka ndihmuar mjaftë shumë.

**z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK;** Përshëndetje, me IOM-in kemi filluar ribashkëpunimin rishtaz, sepse ka qenë i ndërprerë vitin e kaluar. Ne kemi diskutuar për furnizimin e shtëpive që po ndërtohen, për furnizimin e tyre me ujë për pije dhe me kanalizim. Mjetet financiare për participim janë. Mirëpo do ta shohim mundësinë e participimit të IOM-it në këtë projekt. Me KFOR-in kemi pasë bashkëpunim vazhdimisht për sa i përket ndihmave me veshëmbathje me pako ushqimore dhe higjenike.

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** E falënderojmë shoqatën “Rahmeti” e cila e ka ndihmuar Bedredin Ahmetin nga fshati Vojnovc, të cilit ja ka ndërtuar shtëpinë e re prej 100 metrave katror, ndërsa komuna në këtë projekt ka participuar me 750 euro.

**z.Arton Demiri;** Përshëndetje, edhe unë i falënderoj shoqatat IOM-in dhe “Rahmeti” që na kanë ndihmuar. Po ashtu e falënderoj edhe Ibrahimin që ka punuar me ta.

## Pika 3

### Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

**z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK;** Në këtë muaj e kemi një familje të riatdhesuar dhe e kemi sistemuar në një banesë me qira. Fjala është për Emira Maliqin të cilën e kemi sistemuar për një vit. Tjetër nuk ka pas diqka të veçantë, siq e dini për një kohë kam munguar për arsye të pandemisë Covid-19, mirëpo disa punë i ka kryer Egzoniti herë pas here. Deri më 8 shtatorë kemi nda 2000 euro nga zyra për komunitete dhe kthim. Kemi edhe disa kërkesa nga familja Shabani, mirëpo ata bëjnë kërkesa rregullishtë. Nëse ka dikush ndonjë pyetje jamë gati të përgjigjem.

## Pika 4

### Të ndryshme

**Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija;** Dua të bëjë një njoftim me të cilin e falenderoj përgjegjës in e zyrës, që ja ka filluar me ndërtimin e një shtëpie nga komuniteti ashkali, si dhe këto ditë pritet për me ja filluar edhe me një shtëpi tjetër.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija mbledhjen e përfundoi në ora 14.31 h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit  
Rrahman Kadrija

